



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 21 DHJETOR 2018 - VAZHDIM**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 21. DECEMBRA 2018. GODINE - NASTAVAK**

**DHJETOR - DECEMBAR
2018**

Rendi i ditës

I. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 22 nëntor 2018

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 13 shtator, 18, 31 tetor, 2, 7 dhe 23 nëntor 2018

1. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,
2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,
3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
4. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,
5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
6. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
7. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,
8. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,
11. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,
12. Votimi për shkarkimin e z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,
13. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë,
14. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,
15. Votimi për emërimin e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
16. Votimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,
17. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
18. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
19. Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,
20. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,
21. Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,

22. Votimi i kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së GP të PSD-së.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 23 nëntor 2018

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,
5. Votimi në parim i Projektligjit për peticione,
6. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
7. Votimi në parim i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
8. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
10. Përzgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

IV. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 4 dhjetor 2018

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 6 dhe 7 dhjetor 2018

1. Votimi në parim i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019,
2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
3. Votimi në parim i Projektligjit për produktet biocide,
4. Votimi në parim i Projektligjit për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit,
5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës,
6. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
8. Emërimi i një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
9. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media,
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës.

Dnevni red

I. Nedovršene tačka sa vanredne sednicu održane 22 novembra 2018. god.

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo.

II. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 13. septembra, 18. 31. oktobra, 2, 7. i 23. novembra 2018. god.

1. Glasanje u načelu Nacrta zakona o javnom prenosniku Kosova,
2. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br. 02/L-88 o kulturno nasleđe,
3. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
4. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-036 o zvaničnim statistikama Republike Kosova,
5. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-132 o vozilima,
6. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-067 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-063 o železnicama Kosova,
7. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-038 o poštanskim uslugama,
8. Drugo glasanje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
10. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017. godinu,
11. Glasanje za imenovanje 7 (sedam) članova u Kosovskom savetu za kulturno nasleđe,
12. Glasanje za razrešenje g. Shqiprim Pula sa funkcije člana Borda Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komuniciranja,
13. Glasanje Predlog rezolucije sa parlamentarne debate o dijalogu sa Srbijom,
14. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
15. Glasanje za imenovanje predsedavajućeg Odbora Kancelarije regulatora energije,
16. Glasanje Godišnjeg izveštaja o reviziji godišnjih finansijskih pregleda Autobuske stanice u Prištini za 2017. godinu,
17. Glasanje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
18. Glasanje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
19. Glasanje Godišnjeg izveštaja Nezavisne Komisije za medije za 2017. godinu,
20. Glasanje preporuka Komisije za nadgledanje javnih finansija u vezi Godišnjeg izveštaja revizije za 2017.godinu,
21. Glasanje za formiranje Parlamentarne anketne komisije o stanju u PTK i Vala,
22. Glasanje predsedavajućeg u Komisiji za nadgledanje Kosovske agencije za inteligenciju, na zahtev PG SDS-a.

III. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 23 novembra 2018. god.

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Interpelacija Ministra za rad i socijalna pitanja Skender Reçica, na zahtev poslanika Faton Topalli, podržan od 11 poslanika PG PSD, u vezi smrti i povreda radnika na radnim mestima,
5. Glasanje u načelu Nacrta zakona o peticijama,
6. Glasanje u načelu Nacrta zakona za zaštiti od buke,
7. Glasanje u načelu Nacrta zakona o uspostavljanju nacionalne infrastrukture za prostornu informaciju u Republici Kosovo,
8. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br. 05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
9. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za člana Nezavisnog nadzornog saveta civilne službe Kosova,
10. Izbor (1) jednog člana Odbora Radio Televizije Kosova.

IV. Nedovršene tačka sa vanredne sednicu održane 4 decembra 2018. god.

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza.

V. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 6 i 7 decembra 2018. god.

1. Glasanje u načelu N/zakona o budžetskoj podeli budžeta Republike Kosovo za 2019. godinu,
2. Glasanje u načelu N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o Ekonomsko-socijalnom savetu,
3. Glasanje u načelu N/zakona o za biocidnim proizvodima,
4. Glasanje u načelu N/zakona o Komorama arhitekata i inženjera u oblasti građevine,
5. Drugo glasanje N/zakona o izmeni i dopuni zakona br. 20014/32 o porodici Kosova,
6. Glasanje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
7. Glasanje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine,
8. Imenovanje jednog (1) člana Borda RTK-a,
9. Izbor jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije,
10. Razmatranje N/zakona br. 06/L-136 o ratifikaciji Sporazuma o kreditu između Republike Kosova i UniCredit Bank Austria AG za Projekat sistema za uklanjanje otpadnih voda za Opštinu Podujevo.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Në sallë jemi 70 deputetë,

Kemi kushte për votim.

Paraprakisht desha t'ju njoftoj që sot kemi vetëm votime dhe parimisht në kushtet aktuale që kemi në sallë mund t'i kalojmë të gjitha pa problem me votime për ose kundër.

Në qoftë se opozita nuk voton, nuk do të marrë pjesë në votim, atëherë ne duhet të presim derisa ta bëjmë kuorumin. Mendoj se do të ishte mirë të votohen të gjitha.

Unë po e filloj seancën. Zoti Hoti e ka kërkuar fjalën për procedurë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së paraqes një mocion lidhur me rendin e ditës.

Ne kërkojmë që pika e fundit e seancës të mbajtur më 6 dhe 7 dhjetor 2018, që ka të bëjë me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Banka Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës, të rendit si pikë e parë për votim dhe të hedhet në votim menjëherë sapo në sallë të jenë 80 deputetë, sepse kërkohet 2/3 e deputetëve të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë besoj që s'ka asnjë problem të lëvizë rendi i ditës, po e qesim në votim, nuk i kemi 80 deputetë në sallë, i kemi 79, kështu që kur të bëhet 80 deputetë, unë e fus pa problem, në qoftë se s'ka kundër dikush, është një marrëveshje ndërkombëtare në interes të qytetarëve të Besianës, kështu që krejt në rregull është.

Atëherë, po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Kur të bëhen 80 deputetë, më tregoni që ta fusim në votim.

*** Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës**

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 22 nëntor 2018, po nuk ka pasur kuorum për të votuar, andaj sot, të nderuar deputetë, zonja deputete, është koha që ta votojmë, secili mbi bazën e bindjeve të veta.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Opozita po duket se nuk do të votojë.

Kanë votuar 39 deputetë, 36 me kartelë për, një pa kartelë, edhe 3 abstenime.

Numri i duhur nuk ka votuar. E provojmë më vonë, në qoftë se ju mbushet mendja për të votuar.

Po kalojmë te pikat e papërfunduarat nga seanca plenare mbajtur më 13 shtator, 18, 31 tetor 2, 7 dhe 23 nëntor 2018.

Diskutimet për pikat e rendit të ditës nga 1 deri në 8 dhe nga pika 10 deri në 22 kanë përfunduar, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Prandaj, ju lus që të fillojmë me votimin menjëherë.

Zoti Zyba, për procedurë.

SALI ZYBA: Përshëndetje të pranishëm,

Në këtë rend dite pika e trembëdhjetë është kontrabanduar në seancën paraprake, kur konstatoheshin nënshkrimet e subjekteve për seancë të jashtëzakonshme.

Unë me vete kam marrë këtu transkriptin e mbledhjes së Kryesisë, procesverbalet, kam marrë me vete publikimin si rend dite dhe kjo pikë nuk ekziston, është kontrabanduar si pikë.

Andaj, minimum nga ju si udhëheqës i kësaj seance, ose nga sponsorizuesi të sqarohet pozicioni i kësaj pike.

Unë do t'jua deponoj juve, përndryshe të deklarohen grupet parlamentare për këtë pikë.

KRYESUESI: A do kur të shkojmë te pika e rendit të ditës, apo që tani? Në rregull.

Ne do të sqarohemi edhe për këtë çështje. Dihet që për vazhdimin e seancave nuk ka nevojë të mbahen mbledhjet e Kryesisë, veçanërisht kur udhëheqësi ose drejtuesi i seancës nuk e përfundon seancën në fjalë, mund të thirret nga kryetari, edhe me porosi të kryetarit nga administrata ose nënkryetari i Kuvendit.

Diskutimet janë kryer, kur të vijmë te pika, në qoftë se dëshironi prapë të diskutoni, diskutojmë, s'ka ndonjë problem.

*** Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës**

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash! Në këtë gjendje unë mendoj që s'ka nevojë të votohet fare, as të lodhemi, as ju, as unë.

Janë 84 deputetë, po votojnë 37, nuk e di pse. Po presim pra deri sa të bëhet kuorumi i duhur. Atëherë, po marrim gjysmë ore pauzë.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Po aq sa po e shoh, janë 61 deputetë,
Vazhdojmë me seancën parlamentare. Ndërkohë Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mora fjalën për të propozuar një mocion procedural, për të vendosur si pikë të parë të rendit të ditës në këtë seancë votimin në parim të Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe, pas tij, të gjitha projektligjet që janë në lexim të dytë, pas atyre të leximit të dytë, projektligjet që janë në lexim të parë dhe pas projektligjeve në lexim të parë, votimin e raporteve me rekomandime që kanë mbetur nga seancat e kaluara. Meqenëse është konsumuar debati për shumicën prej këtyre pikave dhe besoj që do të ishte një racionalizim i punës së Kuvendit, duke pasur parasysh që janë disa seanca me pika të papërfunduara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Zoti Sejdiu e ka kërkuar fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Kërkoj që pika e trembëdhjetë e rendit të ditës të hiqet, ka të bëjë me propozim-rezolutën e PSD-së për dialogun, kërkoj të hiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI: Propozuesi ka të drejtë ta bëjë këtë, e tërheqim.

Atëherë kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi, ka bërë një propozim.

A ka dikush kundër për këtë mocion procedural, me votë elektronike, është mocion procedural. Shkojmë me votë elektronike.

A dëshironi me ngritje dore? Kush është për, ju lutem? Regjia.

Shumica prezentë është për, po shkojmë me këtë pjesë të rendit të ditës.

*** Votimi në parim i Projektligjit për ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019**

Janë 73 deputetë në sallë. Do të thotë, kemi pasur diskutime, jemi në votim në parim të projektligjit.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, në mënyrë elektronike. Zoti Sejdiu, urdhëro!

DARDAN SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Partia Socialdemokrate e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për buxhetin dhe ka mospajtime në mënyrë se si janë të definuara prioritetet dhe normalisht në mungesën e një qasje zhvillimore.

Këto i kemi shpërfaqur edhe në diskutimet e para në shqyrtimin e Projektligjit për ndarjet buxhetore.

Në situatën në të cilën është sot Kosova dhe ku pritet që viti i ardhshëm të jetë vit ku besojmë se mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë dhe duke pasur parasysh që tashmë kemi një delegacion që është shtetëror për këtë çështje, konsiderojmë që funksionaliteti i Republikës së Kosovës në këtë periudhë kohore nuk guxon në asnjë rrethanë të mbetet peng i instrumenteve të Qeverisë së Serbisë, përkatësisht instrumentit të saj në Kosovë, Listës serbe.

E kemi krejt të qartë që përgjegjësinë politike për mosfunksionim moral të Qeverisë së Kosovës e ka Qeveria, e cila i varri veten që nga themelimi nga ky instrument politik, pra Lista serbe.

Nuk pajtohemi në asnjë rrethanë që buxheti i Kosovës, pagat, investimet dhe orientimet e tjera zhvillimore e sociale, sado problematike që mund të jenë në aspektin parimor, të ndalen apo të pengohen nga ky instrument, edhe sot 20 vjet pas çlirimit.

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër i Financave,

Në mënyrë që në parim të përkrahim projektbuxhetin ne si PSD kemi pesë kërkesa konkrete, për të cilat presim zotim publik nga ju, zoti kryeministër.

I nderuar kryeministër,

Ligji për pagat të miratohet në lexim të dytë, së bashku me leximin e dytë Projektbuxhetit, me theks të veçantë në kërkesat e sektorit të shëndetësisë. Kjo është kërkesa e parë.

I nderuar kryeministër,

Ligji për dialogun të miratohet në Qeveri dhe të dërgohet në Kuvend jo më larg se ditën e hënë, pra më 24 dhjetor 2018, kjo është kërkesa jonë e dytë.

I nderuar kryeministër,

Ligji për Qeverinë të sillet në Kuvend për miratim jo më larg se tre muaj nga sot, ky ligj, i nderuar kryeministër, duhet të saktësoj në mënyrë pa ekuivoqe, përveç tjerash edhe çështjen e numrit të zëvendësministrave për një ministri.

Kërkesë konkrete jona si Parti Socialdemokrate është që nuk mund të ketë më shumë se dy zëvendësministra për ministri. Kjo është kërkesa jonë e tretë.

Kërkesa jonë e katërt, kryeministër,

Kërkojmë nga ju funksionalizimin e plotë të Ministrisë të Bujqësisë, ta keni parasysh që importi kryesor janë gjërat ushqimore dhe rrjedhimisht industria e përpunimit të ushqimit si dhe fermat në Republikën e Kosovës kanë nevojë për një strategji dhe një udhëheqje që ndërton kapacitete për zëvendësim të importeve, edhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e vende të reja të punës.

Rrjedhimisht, i nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kërkojmë nga ju lirimin nga detyra e ministrit të Bujqësisë, i cili nuk po e ushtron këtë detyrë dhe emërimin e një ministri që e funksionalizon ministrinë më të rëndësishme për momentin në betejën që e kemi për zëvendësimin e importeve, pra, atë të bujqësisë.

Dhe kërkesa jonë e fundit, i nderuar kryeministër,

Projektbuxheti i Republikës së Kosovës është tepër i ngarkuar me skema sociale e benefite pensionale.

Janë plot 465 milionë euro në skema të tilla, apo 22% e buxhetit.

Kjo ngarkesë buxhetore për neve si PSD është e lartë dhe ne si Parti Socialdemokrate jemi të bindur që mund të reduktohet.

Disa herë në këtë Kuvend e kam shprehur unë si përfaqësues i këtij subjekti rrugën përpara për të siguruar që të kemi sistem të mirëfilltë pensional, me ç'rast bëjmë një kod pensional, ku definohet edhe kontributi i secilit prej nesh, po edhe benefitet pensionale që duhet gëzuar nga ata që meritojnë pensione dhe përfundimisht, një herë mirë të kemi një kod të mirëfilltë pensional, i cili pastrohet, në të cilin listat e atyre që kanë benefite pastrohen nga keqpërdoruesit e mundshëm.

Këto kursime, i nderuar kryeministër, mund t'i orientojmë më pastaj në edukim, në një fushë e cila për neve është tepër me rëndësi.

Dhe, kërkesa jonë e fundit, i nderuar kryeministër, është që të themelohet një komision i veçantë për draftimin e kodit pensional dhe të bëhet një reformë e plotë e sistemit pensional dhe ky komision të udhëhiqet nga Partia Socialdemokrate.

I nderuar kryeministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Republikës,

Këto kërkesa janë edhe politike, edhe programore, edhe në të mirë të Republikës së Kosovës dhe kërkoj nga ju, kryeministër, një zotim publik para se të keni votën e Partisë Socialdemokrate për projektbuxhetin apo për Ligjin për ndarjet buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Kemi një koordinim të përbashkët, e rëndësishme është për qytetarët e Republikës së Kosovës të kalohet buxheti.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Të gjithë, pra, në radhë të parë deputetë të koalicionit qeverisës prezentë e partnerë, të gjithë,

Po ashtu të respektojmë deputetë të Partisë Socialdemokrate, në këtë rast i nderuar Sejdiu,

Ju në kohën kur Lista serbe ka provuar ta kushtëzojë Kosovën vërtet keni mbajtur qëndrim parimor, qëndrime që i kanë mundësuar vendit e Qeverisë të ecin disa tema që janë me rëndësi, ndër to, ajo e ushtrisë që na gëzon të gjithëve.

Kërkesat që i cekët sot janë të drejta dhe ne në diskutim si koalicion qeverisës marrim obligimet për këto kërkesa, i marrim obligimet për këto kërkesa, ashtu si i cekët ju, pra që të hënën që vjen fillojmë edhe me zbatimin e të parës, me votimin e Ligjit për dialogun me Qeverinë dhe ta sjellim këtu. Ju falënderoj për mirëbesimin!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Përgatitemi për votim, të nderuar kolegë deputetë,

Deputetët të kthehen në sallë, ata që janë në bufe.

Bini ziles, ju lutem, edhe një herë, ka deputetë, por po presim të vijmë të gjithë, vetëm bini ziles, regjia, dhe do të hyjmë në votim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përgatitemi për votim,

Jemi në votimin në parim të Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 62 për.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-133 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet parlamentare që ta shqyrtojnë Projektbuxhetin për vitin 2019 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

E kemi në votim shumë me rëndësi, është me 2/3 e votave, ka të bëjë me komunën e Podujevës, projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza, po na duhen 2/3, jam i detyruar ta mbaj anash deri në momentin kur janë tërë deputetët, ka qenë pika e dhjetë.

*** Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete**

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej katër amendamente.

I votojmë amendamentet 1 e 2, janë bashkë, në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, vetëm me dorë, dy të tjerat në mënyrë elektronike.

Amendamentet 1 dhe 2.

Janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

A është dikush kundër? Abstenim? Shkojmë në fund të ligjit, njëjtë e keni. Nuk merrni pjesë.

Amendamentet 1 dhe 2 s'po shkojnë, po e mbaj anash një herë.

*** Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës**

Në seancën plenare të mbajtur më 14 shtator 2018 janë miratuar amendamentet e propozuar për këtë projektligj. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash:

62 deputetë kanë votuar, 61 për, një abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

*** Votimi në lexim të dytë i Projektligjit numër 06/L-038 për shërbimet postare**

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 deputetë për.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-038 për shërbime postare.

*** Votim në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash:

53 deputetë kanë votuar, edhe këtë do ta provojmë edhe një herë.

A janë 61 deputetë në sallë, 62 deputetë janë në sallë.

*** Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomik Social**

Votojmë në parim projektligjit, tash: e presim regjinë deri të përgatitet, ju lutem. Regjia kur të bëhet gati votimi në parim i projektligjit. Pika e dytë ka qenë, regjia pika më e lehtë. Votojmë tash! 62 deputetë kanë votuar, 61 për, 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

*** Votimi në parim i Projektligjit për produktet biocide**

E votojmë në parim projektligjin, tash! 62 deputetë kanë votuar për.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06L-130 për produkte biocide.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

*** Votimi në parim i Projektligjit për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit**

E votojmë në parim projektligjin, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 60 për, 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06L-132 për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

*** Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës**

Në këtë projektligj nuk është propozuar asnjë amendament, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për.

Kuvendi e miratoi ligjin nr.06L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

*** Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës**

Në seancën plenare të mbajtur më 2 dhe 7 nëntor janë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj. E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, votojmë tash!

Ju kisha lutur, regjia deri të bëhet gatit, ka të bëjë me votimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës. Numër 4 ka qenë në vijë rendore. Votojmë tash!

61 deputetë, 61 kanë votuar për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

*** Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës**

E votojmë projektligjin, votojmë tash!

46 deputetë kanë votuar, nuk e ka cilësimin e nevojshëm të votimit.

*** Votimi në parim i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës**

Regjia dhe deputetët, votojmë tash! Regjia, numër 7 jemi. Krijimi i infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, numër 7, më 23 nëntor. Kërkojmë falje, por regjia s'ka faj se i kemi... Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 për.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06L-127 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

*** Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave**

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji, votojmë tash!

Po ashtu, numri i deputetëve që kanë votuar 45, nuk është i cilësuar për t'u llogaritur si i vlefshëm.

Do të kthehemi edhe njëherë të shkojmë... Votimi në parim, numër 6, regjia.

*** Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga zhurma**

Votojmë tash! Ky është 59, nuk është i cilësuar si votim. Do të kthehemi edhe një herë në qoftë se dëshironi. A dëshironi edhe një herë? Votojmë edhe njëherë të njëjtin. Regjia, votimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga zhurma, votojmë tash!

56 deputetë kanë votuar, nuk është e cilësuar për votim.

*** Votimi në parim i Projektligjit për peticione**

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji, votojmë tash!
51 deputetë kanë votuar, nuk e ka votën e cilësuar të vlefshme.

*** Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017**

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë tash! Jemi te pika 10, votojmë tash!

57 deputetë kanë votuar, nuk e ka cilësimin e vlefshmërisë.

*** Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës për vitin 2017**

Procedojmë me votimin e rekomandimeve, votojmë tash! Pika 6, regjia! Regjia pika 6, Ministria për Rini, Kulturë dhe Sport, raporti. 6 dhe 7 dhjetor 2018, votojmë tash!

Ministër, a ta votojmë? Po, për atë.

58 deputetë kanë votuar, nuk e ka cilësimin e nevojshëm të vlefshmërisë.

*** Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017**

Votojmë tani! Pika e 7, po mirë, votojmë tani.

59 vota janë, nuk e ka vlefshmërinë e cilësuar.

*** Votimi për shkarkimin e zotit Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

Votojmë rekomandimet e Komisionit Funkcional. Pika 12, regjia. Votojmë tash!

50 deputetë kanë votuar, nuk është e cilësuar në bazë të vlefshmërisë.

*** Votimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë sh. a., për vitin 2017**

E votojmë raportin. Pika 16, regjia. Për Stacionin e Autobusëve jemi duke pritur. Votojmë tash!

60 vota janë... Me dorë, Milaim a je i sigurt. Atëherë, në qoftë se Administrata e vërteton 61 vota. 54 për, 3 kundër, 4 abstenime. Regjia, vërtetoheni në qoftë se nuk është vota e Milaimit në mënyrë elektronike.

Atëherë, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për mbikëqyrjen e financave publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë sh. a., për vitin 2017.

*** Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**

E votojmë raportin, tash. Pika e 17, regjia. Votojmë tash!

59 deputetë, nuk e ka cilësimin e vlefshmërisë së votës.

*** Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi**

E votojmë raportin tash!

Janë 59 deputetë. Nuk e ka cilësimin e vlefshmërisë.

Ne do të kthehemi edhe një herë, regjia të bëhet gati. Edhe një herë do të kthehemi në mënyrë formale në këto të cilat i kemi kaluar. Vetëm të shkojmë deri në fund me votimet njëherë.

Regjia 18 pika e rendit të ditës. Votojeni ju lutem këtë raport të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, tash!

60 deputetë kanë votuar, nuk e ka cilësimin e vlefshmërisë së votës.

*** Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017**

E votojmë raportin. Regjia 19, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 57 për, 3 kundër, 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017.

*** Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017**

I votojmë rekomandimet tash!

62 deputetë kanë votuar, 57 për, 5 abstenime.

Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017.

*** Votimi i kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së GP të PSD-së**

Grupi Parlamentar i PSD-së e ka propozuar deputetin Faton Topalli për kryetar të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e kësaj agjencie.

Procedojmë me votimin e emërimit të kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, deputetit Faton Topalli.

Votojmë tash!

59 deputetë kanë votuar. Nuk e ka cilësimin e nevojshëm të vlefshmërisë.

*** Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor, ka kërkuar nga grupet parlamentare propozimin e deputetëve për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Grupet parlamentare disa i kanë propozuar, disa jo.

Lidhja Demokratike e Kosovës, Lirie Kajtazin e ka kryetare, Armend Zemajn anëtar.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, kush janë anëtarët e Komisionit? Memli Krasniqi, kush janë anëtarët e Komisionit?

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar,
E kemi dërguar me shkresë në Sekretari.

KRYETARI: Po, na e lexo se nuk prish punë.

MEMLI KRASNIQI: Jo nuk e kam shkresën me vete, e ka Sekretaria, se kjo ka qenë para shumë e shumë kohe.

KRYETARI: Ndërkohë Sekretaria ju lutem na e sillni, se na duhet votimi formal. Po vazhdoj. Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, Valon Ramadani anëtar, Adem Mikullovcu anëtar.

Nga PSD-ja është Shqipe Pantina. Nga AAK-ja Rasim Selmanaj.

Lista serbe nuk e ka sjellë. Nga Nisma, Zafir Berisha.

6 +, kë e keni anëtar? Albert Kinolli, të lutem! Zonja Mufera Serbica Shinik, urdhëro!

MUFERA SHINIK: Albert Kinollin, kryetar!

KRYETARI: Z. Krasniqi, a e ke kërkuar edhe një herë fjalën si shef i Grupit Parlamentar, urdhëro.

MEMLI KRASNIQI: Po e kërkoja edhe një herë, pasi Sekretaria i paska letrat e grupeve të tjera, e bash të Grupit të PDK-së nuk e paska, të ju njoftoj edhe formalisht që ne e kemi përcaktuar deputeten Blerta Deliu-Kodra dhe deputetin Bekim Haxhiu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani i kemi të gjitha propozimet. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për formimin e këtij Komisioni ad hoc. Votojmë tash!

Deputetët të kthehen në sallë se nuk ka numër të mjaftueshëm, janë 54 deputetë. Le të kthehen në sallë, i kisha lutur. E kemi edhe një...

54 deputetë kanë votuar, s'e ka cilësinë e vlefshmërisë.

10 minuta pauzë, e vazhdojmë seancën, pasi në sallë janë 54 deputetë, që ta dini. 10 minuta pauzë, përkatësisht deri në 16:45. 15 minuta pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë!

A ka mundësi regjia të na krijojë mundësitë, se Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën. Jemi në vazhdim të seancës. Para se të futem në pikat e rendit të ditës, kryetari i Grupit Parlamentar të Nismës e ka kërkuar fjalën. Urdhëro z. Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po, unë e kërkoja fjalën për të protestuar për papërgjegjshmërinë e atyre që vijnë këtu dhe qëndrojnë jashtë, e nuk vijnë këtu në seancë. Nuk e kam fjalën këtu për ata të opozitës sepse ata kanë arsye politike, të drejta a të gabuara i vlerëson zgjedhësi, po për deputetët e mazhorancës dhe ata që ishin të gatshëm të vazhdojnë seancën që nuk po qëndrojnë këtu. Dhe, nuk është në rregull për shkak të papërgjegjshmërisë së tyre, ne të tjerët të përgjegjshëm presim atë dhjetëminutëshin të na bëhet një orë e gjysmë.

KRYETARI: Faleminderit! Regjia, ju kisha lutur ta bëni edhe një herë një thirrje, e fundit le të jetë, dhe ta konstatojmë gjendjen e cila është në sallë, për vetë faktin se vërtet nuk është mirë që disa nga deputetët të cilët janë të përgjegjshëm, të qëndrojnë. Në qoftë se e shohim se nuk janë 61 deputetë.

51 deputetë janë. I kisha lutur deputetët të cilët janë në ambientet e Kuvendit, do të presim edhe pesë minuta maksimum në sallë, nuk do të lëvizim. 51 deputetë janë në sallë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë!

Vazhdimi i seancave për shkak të mungesës së kuorumit do të bëhet në momentin kur të ju njoftoj si kryetar i Kuvendit. Javën e ardhshme do të kemi seancë. Të jeni të sigurt. Do të ju lajmëroj. Më fal! Pa e marrë vendimin edhe një herë, por këta kolegët deputetë i paskan bërë tamam 40 nënshkrime qenkan, dhëntë Zoti janë tamam, se nganjëherë po na i bëjnë... Sekretar, Administrata, a ma jepni në autoritet të plotë të Administratës?

Kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme për datë 26 dhjetor, në orën 10:00, sa i përket pozicionit të shtetit tonë në dialogun me Serbinë. Kjo është vetëm për njoftim, edhe një herë, ju lutem! Kjo ishte për korrektësi. E marrim seriozisht, pastaj unë e thërras mbledhjen e Kryesisë në momentin e caktuar. Ta keni parasysh, dita është e mërkurë, 26 dhjetor 2018, në orën 10:00. Në shumicën absolute të rasteve, ne e kemi respektuar kërkesën e 40 deputetëve. Do të thotë, ishte vetëm sa për njoftim. Mirupafshim! Faleminderit!

* * *

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë